Kronikë

Plagosja në Shijak, tregtari i makinave Ardjan Çyrbja u qëllua me pistoletë në sy të bashkëshortes e fëmijës

Mësohet se Ardjan Çyrbja ka qenë në shoqërinë e bashkëshortes dhe të fëmijës së tij në momentin kur dhe është qëlluar nga Eriv Hodo

Plumb 50 vjeçarit në Shijak, policia në ndjekje të autorit

Foto nga vendi i ngjarjes

Redaksia
2 Qershor, 10:55 | **Përditesimi: 2 Qershor, 13:25**

Zbulohen detaje të reja lidhur me plagosjen e ndodhur mbrëmjen e 1 qershorit në lagjen "Popullore" në Shijak të Durrësit.

Policia ka shpallur në kërkim si autor të dyshuar Ervis Hodon.

LEXO EDHE:
Durrës/ Nuk respektonin rregullat e qarkullimit rrugor! Policia gjobit qindra drejtues mjetesh

Mësohet se Ardjan Çyrbja ka qenë në shoqërinë e bashkëshortes dhe të fëmijës së tij në momentin kur dhe është qëlluar nga Ervis Hodo me të cilin sipas policisë fillimisht kanë pasur një konflikt. Bashkëshortja është afruar dhe i ka kërkuar autorit të mos qëllonte më, informon gazetari i Report TV, Artur Korriku.

Mësohet se 50 vjeçari është qëlluar me pistoletë mulli dhe ka marrë tre plagë, një në bark, një në ije dhe një afër zemrës, ndërsa autori është larguar nga vendi i ngjarjes dhe është ende në kërkim.

Ervis Hodo mësohet se është nga Dibra por prej disa vitesh jetonte në Shijak ku dhe kishte banesën Ardjan Çyrbja i cili merret me tregti makinash.

Hyri për të shuar sherrin në lokal

Që të dy më herët kanë pasur një konflikt verbal me njëri tjetrin në një lokal në Shijak mbrëmjen e së enjtes dhe shkak ka qenë zëri i Iartë.

Në fakt 38 vjeçari ka qenë duke u konfliktuar me një tjetër person dhe Çyrbja kishte ndërhyrë për ti ndarë, por më pas ishte përfshirë edhe ai në konflikt.

Autori ka pritur që Çyrbja të largohet drejt shtëpisë kur dhe i ka dalë para dhe e ka qëlluar. 50 vjeçari ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve dhe sipas informacioneve nga bluzat e bardha plumbi i ka dëmtuar njërën mushkëri kurse dy plagët e tjera kanë qenë me pasoja anësore.

S.G/M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Ervin Hodo | shijak | Durres | Ardjan Çyrbja

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
I kishte mbetur 1 vit e 8 muaj burg, gjykata liron Tahirin, si e vlerësoni

E drejtë | E gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Plumb 50 vjeçarit në Shijak, policia në ndjekje të autorit
1 Qershor, 23:28

Monitorimi ajror zbuloi mbi 2600 rrënjë kanabis! Report Tv siguron itinerarin, avioni 'skanoi' nga ajri në mëngjes, policia i asgjësoi në mesditë
Sokol Dema
1 Qershor, 17:21

Asgjësohen 140 rrënjë kanabisi në Krujë, një në pranga! Shpallet në kërkim djali i tij
1 Qershor, 15:34

Nëna 22-vjeçare rrahu djalin në Durrës, Agjencia Shtetërore për mbrojtjen e Fëmijëve: Nëse përsëritet situata, i merret kujdestaria
Ledina Jakimi
31 Maj, 16:22

'Rërë falas', shtohet hapësira për plazhe publike në Durrës, shkon në 30%! Sako: Ky sezon do të jetë sukses për turizmin
Aldo Mustafa
31 Maj, 13:49

Operacion anti-drogë në Krujë, Lezhë dhe Shkodër! Asgjësohen 6262 rrënjë kanabisi
31 Maj, 13:45

Berisha akuza për manipulimin e zgjedhjeve të 14 majit: U përdorën 'zgjedhës shtëtitës' pa adresë që votonin më shumë se në një qendër votimi
31 Maj, 12:51

Vonesat në shkarkimin e anijeve, linjat detare letër Ramës: Na jepni zgjidhje për kostot shtesë dhe pagesat nën dorë
31 Maj, 09:48

Sot dhe nesër probleme në furnizimin me ujë në disa lagje të Durrësit, UKD: Shkak ndërhyrja që do kryhet në këto dy zona ku do ketë edhe mungesë energjie
31 Maj, 08:52

Rrahu fëmijën në Durrës, nëna 22-vjeçare hetohet në gjendje të lirë! Policia: U mor ky vendim se ka foshnjen 6 muajshe
30 Maj, 10:05

VIDEOLAJM/ Rama publikon pamje nga plazhi i Durrësit: Po punohet për shtrirjen e shtresave të rërës dhe dezinfektimin sezonal, presim më shumë turistë
30 Maj, 08:02

Lulzim Basha në Durrës: Kjo nuk është fushatë për kreun e partisë! Ata që thurin plane, ta harrojnë se do e zhdukin PD-në
29 Maj, 18:29

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje